



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 07 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1420_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25 dhe Nenin 26 par.1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 dhe Nenin 22 par. 2 nënpar. 2.3 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja nga BRE;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_924_2018 të datës 29 mars 2018, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Kotlina, HC "Kotlina" me kapacitet të instaluar prej 4.9 MW, ZK Kotlinë në Komunën e Hanit të Elezit, të datë 15.03.2021, Nr. 201/21 të shoqërisë "AFA Energy" SH.P.K., me adresë: Lagjja "Ariu" Nr. 10 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 07 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** - Kërkesa e shoqërisë "AFA Energy" SH.P.K., për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_924_2018 të datës 29 mars 2018, dhe njëkohësisht Përfundon afati i vlefshmërisë së këtij Vendimi.

A r s y e t i m

- o ZRRE, më 12.06.2015 nga shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., ka pranuar aplikacionet për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Kotlina për HC "Kotlina 1" me kapacitet të instaluar prej



2.4 MW ZK Kotlinë Komuna e Kaçanikut dhe HC "Kotlina 2" me kapacitet instaluar prej 2.7 MW, dhe ZK Pustenic, komuna e Hanit të Elezit, Republika e Kosovës.

- ZRRE, pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali, me datë 28 janar 2016 ka Lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_769_2016 dhe V_770_2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Vendimet mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimet mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar janë lëshuar në afat një (1) vjeçar dhe në këto vendime është përcaktuar se shoqërisë "AFA Energy" SH.P.K., do t'i jepet Autorizimi Final për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final, duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- ZRRE, me datë 24.01.2017 nga shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_769_2016 dhe V_770_2016 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Kotlina HC "Kotlina 1" me kapacitet të instaluar prej 2.4 MW, ZK Kotlinë, Komuna e Kaçanikut dhe HC "Kotlina 2" me kapacitet të instaluar prej 2.7 MW, ZK Pustenic, komuna e Hanit të Elezit, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante me datë 09.02.2017 ka aprovuar kërkesat me Vendimin V_884_2017 dhe V_885_2017 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_769_2016 dhe V_770_2016 dt. 28 janar 2016, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 28 korrik 2017, në mënyrë që brenda kësaj periudhe të kompletohet aplikacioni për marrjen e Autorizimit Final.
- ZRRE, më 24.07.2017, brenda afatit ligjor nga shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali, në Lumin Kotlina për HC "Kotlina 1" me kapacitet të instaluar prej 2.4 MW dhe HC "Kotlina 2" me kapacitet 2.7 MW, që bashkohen në një hidrocentral HC "Kotlina" me kapacitet total 4.9 MW, vepra marrjes ZK Kotlinë, Komuna e Kaçanikut dhe ndërtesa e Hidrocentralit ZK Pustenic Komuna e Hanit të Elezit, duke i bashkëngjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës dhe Lejen Ndërtimore si dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 29 mars 2018 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_924_2018 shoqërisë "AFA Energy" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin



e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Kotlina, ZK "Kotlinë", me kapacitet të instaluar prej 4.9 MW, komuna e Hanit të Elezit.

- ZRRE me datë 15.03.2021 nga shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_924_2018 të datës 29 mars 2018, për HC "Kotlina", me kapacitet të instaluar prej 4.9 MW, në lokacionin ZK Kotlina, komuna e Hanit të Elezit, edhe për një (1) vit.
 - Shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: për shkak të situatës me pandeminë COVID19, nuk kanë mundur të zhvillojnë ecurinë e realizimit të punimeve ndërtimore të hidrocentralit është penguar nga gjendja e pandemisë globale nga COVID -19, dhe e masave ndaluese të veprimtarisë të ndërmarrja nga Ministria e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve me urdhëresën nr. 01/0740, datë 12.04.2020. Ndërsa si vonës tjetër është për shkak të pandemisë globale COVID 19 ka ardhur nga kompania furnizuese me pajisjet elektromekanike e cila ka njoftuar se nuk mund të realizojë liferimin dhe montimin e pajisjeve për shkak të restriksioneve në punë dhe pamundësisë së kryerjes së aktiviteteve si shkak i rregullave të kufizuara të lëvizjes dhe mbyllja totale.
 - ZRRE me datë 17.09.2021, kanë realizuar vizitën monitoruese në terren, në vend-punishte, në lokacionin ZK Kotlinë, komuna e Hanit të Elezit për të parë nga afër punimet sipas planit dinamik të realizimit të prezantuar nga vet aplikuesi, brenda periudhës së autorizimit final dhe për të vërtetuar arsyeshmërinë e kërkesës për shtyrje. Pas vlerësimit të situatës në vend punishte, ishte vërtetuar se aplikuesi nuk ka realizuar punimet sipas planit dinamik të prezantuar nga ana e tij, pasi që gjendja në terren është fillestare, përkundër afatit prej më shumë se tre (3) vite, nga koha e lëshimit të Autorizimit.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final, vlerësimin e gjendjes faktike nga Raporti i Monitorimit në vend-punishte dhe duke marr parasysh se aplikuesi nuk ka realizuar punimet sipas planit dinamik të prezantuar nga ana e tij, ka vlerësuar se kërkesa është e pa bazuar dhe nuk janë përmbushur obligimet e Autorizimit sipas dispozitave ligjore të Rregullës së Autorizimit, andaj duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - Shoqëria "AFA Energy" SH.P.K., ka të drejt të ri-aplikoj për marrje të Autorizimit pas plotësimit të kushteve ligjore sipas dispozitave të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe mund t'iu nënshtrohet vetëm dispozitave ligjore të Kreut III. të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.
- II. Vendimit për Autorizimin Final V_924_2018 i datës 29 mars 2018, shfuqizohet dhe njëkohësisht sipas fuqisë ligjore të Nenit 44 par. 2 të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë e lidhur me dt. 18.07.2018 nr. Prot. 874 mes KOSTT dhe AFA Energy SH.P.K. anulohet në tërësinë e saj.
- III. Vendim nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Bregullatorit:



Ymer Fejzullahu, Kryesues



Selman Hoti, Anëtar



Izet Rushiti, Anëtar



Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.